



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DREJTORIA E VLERËSIMIT TË ANKESAVE

Nr.2087/3 Prot

Tiranë, më 29.12.2022

VENDIM

Nr.69, datë 29.12.2022

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Ankuesi, z. _____, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Komisioneri”) Formularin e Ankesës nr. 2087 prot., datë 12.12.2022, me objekt “*Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare*”, kundër Autoritetit Publik Bashkia Divjakë (në vijim “Autoriteti Publik”).

Ankuesi, nëpërmjet kërkesës depozituar në adresën e postës elektronike, info@bashkiadivjake.gov.al, në datën 17.11.2022, ka kërkuar t’i vendoset në dispozicion informacioni/dokumentacioni në lidhje me:

1. *Një kopje të “Deklatatës Paraprake për kryerje Punimesh” ose kërkesën e paraqitur nga subjekti në fjalë për realizimin e punimeve të sipërpërmendura;*
2. *Kopje të projektit të realizimit të punimeve që ka paraqitur subjekti, në përputhje me llojin e punimit që kërkon të kryejë;*
3. *Aktin e miratimit (apo lejen) që Bashkia e Divjakës ka lëshuar;*
4. *Dokumentin në të cilin është shënuar masa administrative ndaj subjektit Agro Fish Hoti;*
5. *A është ekzekutuar vjelja e kësaj gjobe dhe cilit prej autoriteteve publike (qëndrore apo vendore) i ka kaluar vlera e kësaj mase administrative?*

Autoriteti Publik, me shkresën nr. 6812/1 prot., datë 20.12.2022, protokolluar pranë Zyrës së Komisionerit me nr. 2087/2 prot., datë 22.12.2022, ka informuar Zyrën e Komisionerit se i ka kthyer përgjigje z.

, nëpërmjet e-mailit, të datës 14.12.2022, për kërkesat duke cituar se: *"...Në vijimësi të komunikimeve elektronike, në përgjigje të kërkesës suaj për dërgim informacioni lidhur me projektin dhe lejen e aplikuar nga subjekti Agro Fish Hoti në Bashkinë Divjakë ju bëjmë me dije se:*

1. Subjekti Agro Fish Hoti ka aplikuar në sistemin e-leje për tu pajisur me lejen "Deklaratë paraprake për kryerje punimesh" më datë 28.04.2022. Pas shqyrtimit të procedurës, si dhe dokumentacionit bashkëlidhur këtij aplikimi, subjekti u pajisë me lejen "Deklaratë paraprake për kryerje punimesh" më datë 29.04.2022 me objekt: "NDËRTIM SERE DIELLORE ME THEMELE TË PAVAZHDUARA ME TRE BLOQE".

2. Subjekti "Agro Fish Hoti" ka aplikuar pranë Bashkisë Divjakë për tu pajisur me leje ndërtimi "Leje ndërtimi për ndërtim të ri me sipërfaqe më të madhe se 250 m²" më datë 25.08.2022. Pas shqyrtimit të dokumentacionit, si dhe ndjekjes së procedurës për vlerësimin teknik dhe ligjor të kësaj leje, subjekti u pajisë me lejen e ndërtimit "Leje ndërtimi për ndërtim të ri me sipërfaqe më të madhe se 250 m²" më subjekt "MAGAZINË BUJQËSORE IKT PËR GRUMBULLIM-PAKETIM TË FRUTA PERIMEVE, AMBJENTE SHËRBIMI DHE REZERVUAR UJI".

Gjithashtu ju informojmë se subjekti ka shlyer të gjitha detyrimet financiare konform "Ligjit për planifikimin dhe zhvillimit të Territorit", LIGJI Nr. 9788 datë 16.07.2007 "për Inspektimin e Ndërtimit" si dhe Vendimeve të Këshillit Bashkiak...".

Pas përgjigjes së sipërcituar, ankuesi pretendon se: *"...Autoriteti Publik nuk më ka vendosur asnjë nga dokumentet e kërkuara në dispozicion..."*

Në vijim, ankuesi kërkon nga Zyra e Komisionerit, ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit, si dhe urdhërimin e Autoritetit Publik për dhënien e informacionit/dokumentacionit të cituar si më sipër.

Zyra e Komisionerit pas shqyrtimit paraprak të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, vlerësoi se ankesa përmbush kriteret formale ligjore, në përputhje me përcaktimet e nenit 24 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" (në vijim "LDI").

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, si hap paraprak përpara marrjes së vendimit, në përputhje me nenin 10 të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", i cili parashikon: *"Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjëndje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur"*, Zyra e Komisionerit, me shkresën nr. 2087/1 prot., datë 15.12.2022, ka kërkuar qëndrimin e Autoritetit Publik, në lidhje me pretendimin e ngritur nga ankuesi, si dhe sqarime në lidhje me disponimin e dokumentacionit të kërkuar, brenda datës 22.12.2022.

Autoriteti Publik, nëpërmjet shkresës nr. 6812/1 prot., datë 20.12.2022, ka kthyer përgjigje duke cituar se: “...ju bëjme me dije se Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit Divjakë” i ka kthyer përgjigje kërkesës së z. në mënyrë elektronike me date 14.12.2022...”.

Pas përgjigjes së sipërcituar, ankuesi ka rikonfirmuar qëndrimin e reflektuar në ankesë nëpërmjet e-mail-it të datës 27.12.2022.

Pas konsultimit të legjislacionit përkatës dhe dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ, Komisioneri vlerëson se, qëndrimi i Autoritetit Publik nuk është në përputhje me dispozitat e LDI, si dhe detyrimet që burojnë nga ky i fundit.

Bazuar në shkronjën “a” të pikës 1 të nenit 2 të LDI parashikohet se: “*Autoritet publik*” është çdo organ administrativ i parashikuar në legjislacionin në fuqi për procedurat administrative, organet ligjvënëse, gjyqësore dhe ato të prokurorisë së çdo niveli, organet e njësisve të qeverisjes vendore të çdo niveli, organet shtetërore dhe entet publike, të krijuara me Kushtetutë ose me ligj”.

Në kuptim të këtij parashikimi, Bashkia e Divjakës është Autoritet Publik dhe subjekt i LDI, për rrjedhojë detyrohet për zbatimin e tij, duke garantuar njohjen e publikut me informacion në kuadër të transparencës.

Për të mundësuar realizimin e objektit dhe qëllimit të tij, LDI, në pikën 1 të nenit 1 përcakton se: “1. Ky ligj rregullon të drejtën e njohjes me informacionin që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike. Në këtë kuptim, çdo autoritet publik pavarësisht nëse është në cilësinë e “prodhuesit” apo “mbajtësit” të informacionit, detyrohet të garantojë njohjen e publikut me informacion, në kuadër të ushtrimit të të drejtave dhe lirive të individit në praktikë, si dhe të formimit të pikëpamjeve për gjendjen e shtetit dhe të shoqërisë.

Nga shqyrtimi i çështjes, konstatohet se objekti i kërkesës lidhet me kopje dokumentacioni sipas pikave të kërkesës për informacion, të lëshuar nga Autoriteti Publik.

Për sa më sipër, informacioni i kërkuar përmbush kërkesat e pikës 2, të nenit 2, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, sipas të cilit “*informacion publik*” konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik”. Rrjedhimisht, ekzistenca e informacionit/dokumentacionit të mësipërm pavarësisht nëse ai është i prodhuar apo administrohet nga Autoriteti Publik, ngarkon me përgjegjësi këtë të fundit, për vënien në dispozicion të informacionit/dokumentacionit të kërkuar.

Autoriteti Publik, për vënien në dispozicion të informacionit/dokumentacionit të kërkuar, duhet të mbajë në konsideratë parashikimin sipas pikës 6 të nenit 17 të LDI, ku përcaktohet se: “*Nëse kufizimi prek vetëm një pjesë të informacionit të kërkuar, pjesa tjetër nuk i refuzohet kërkuarit. Autoriteti Publik tregon qartë pjesët e dokumentacionit përkatës që janë refuzuar, si dhe në bazë të cilës pikë të këtij neni është bërë ky refuzim*”.

Për sa më sipër, Autoriteti Publik në përputhje me dispozitën e sipërcituar duhet të kishte trajtuar kërkesën për informacion.

Si përfundim, Komisioneri thekson se, LDI ka për qëllim të nxisë përforcimin e integritetit, të transparencës e të përgjegjshmërisë së Autoriteteve Publike.

Për sa më sipër, bazuar në pikën 3, të nenit 3 të LDI, “Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit original ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit”.

E drejta për informim është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Pranimin e ankesës së z. _____, nr. 2087 prot., datë 12.12.2022, ndaj Autoritetit Publik, Bashkia Divjakë, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare”.
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik, për vënien në dispozicion të informacionit/dokumentacionit sipas kërkesës për informacion datë 17.11.2022, konkretisht: “ 1) Një kopje të “Deklatatës Paraprake për kryerje Punimesh” ose kërkesën e paraqitur nga subjekti në fjalë për realizimin e punimeve të sipërpërmendura. 2) Kopje të projektit të realizimit të punimeve që ka paraqitur subjekti, në përputhje me llojin e punimit që kërkon të kryejë. 3) Aktin e miratimit (apo lejen) që Bashkia e Divjakës ka lëshuar. 4) Dokumentin në të cilin është shënuar masa administrative ndaj subjektit Agro Fish Hoti. 5) A është ekzekutuar vjelja e kësaj gjobe dhe cilit prej autoriteteve publike (qëndrore apo vendore) i ka kaluar vlera e kësaj mase administrative?”, brenda datës 10.01.2023.
3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani, sipas nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
4. Ky vendim u shpall sot në datë 29.12.2022.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi